



UNIVERSITETI I PRISHTINËS UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11553

Datë: 30/6/2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, shpall:

KONKURS për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik 2025/2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 20 pika 2, nën-pika 2.2 dhe në zbatim të nenit 98, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2025, ka miratuar propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2025/26 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet themelore - baçelor.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2025/2026, do të regjistrojë **5654** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-t, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **672** studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej **12%** e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahe në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të pranohen deri në **2%**, përkatësisht deri në **112** kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, deri në **2%**, përkatësisht deri në **115** nga Maqedonia e Veriut dhe Republika e Shqipërisë dhe deri në **1%**, përkatësisht deri në **70** kandidatë nga Mali i Zi. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërsënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përjashtimisht kushteve të veçanta, të përcaktuara për kandidatët si në pikat 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit, do t'ua shtojë nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohe me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

8. Në universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jokosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi kosovare.
10. Dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet në njësinë akademike përkatëse nga koordinatori për zhvillim akademik.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën, në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim, përveç në rastet specifike, ku testi do të përgatitet në gjuhën, në të cilën zhvillohet programi (p.sh. në programet e Fakultetit të Filologjisë: Gjuhë dhe Letërsi Angleze; Gjuhë dhe Letërsi Gjermane; Gjuhë dhe Letërsi Frënge; Gjuhë dhe Letërsi Turke dhe Orientalistikë).
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti joshumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik, duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. **Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 391 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale. Kandidati/ja që mbi bazën e deklarimit të rrejshëm apo dokumentacionit të falsifikuar, ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në Universitetin e Prishtinës, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga Universiteti i Prishtinës, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë.**
14. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
15. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2025/26 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arkitekturës, do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë.**
Për Fakultetin e Arkitekturës, përzgjedhja është pasqyruar te Fakulteti i Arkitekturës.
 - a) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**
 Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**
 Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë dhe
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues, deri në numrin e paraparë sipas konkursit.**

3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
4. **Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafët 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
7. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar t'ia dërgojnë rektoratit të universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e fakultetit.
8. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimin ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve.
9. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - a) Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta;
 - b) Kandidati/ja i/ cili/a ka sukses më të mirë të shkollës së mesme, e nëse edhe pikët e provimit pranues dhe të suksesit të shkollës së mesme janë të njëjta;
 - c) Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë nga testi i maturës.
 - d) Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përzgjedhja e kandidatit/es fitues, do të bëhet përmes tërheqjes së shortit në prani të kandidatëve me pikë të barabarta si në paragrafët a), b) dhe c) të pikës 9.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> do të jetë i hapur prej datës **30.6.2025** deri më datë **8.7.2025** në orën 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **30.6.2025**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **13:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **30.6.2025** deri më **8.7.2025**. Gjatë kësaj periudhe, gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose të noterizuara);*
 - c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - e) *Kopjen e letërnjoftimit;*
 - f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;***
 - g) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend sigurohet në MASHTI nga Administrata Qendrore e UP-së (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*

6. Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.
7. Nëse gjatë aplikimit online, kandidati gabimisht aplikon në një program tjetër studimor, atëherë duhet të kërkojë nga zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës t'i fshihet aplikimi i gabuar nga sistemi, në mënyrë që t'i mundësohet procedura e aplikimit nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundojë para datës së mbylljes të aplikimit online.
8. Pas nxjerrjes së dokumenteve publikatë për aplikim fizik, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.
9. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqet e këtyre fakulteteve.
10. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të paraqitura si më poshtë:

Grupi I:

1. Fakulteti Filozofik, me datë **10.7.2025**, në orën **9:00**;
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, me datë **10.7.2025**, fillon në orën **14:00**;
3. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, me datë **10.7.2025** dhe **11.7.2025**, në orën **8:00**;
4. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, me datë **10.7.2025**, fillon në orën **14:00**;
5. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, me datë **10.7.2025**, në orën **9:00**;
6. Fakulteti Juridik, me datë **10.7.2025**, në orën **9:00**.
7. Fakulteti i Arteve, me datë **10.7.2025, 11.7.2025 dhe 12.7.2025**, në orën **9:00**.
8. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, me datë **10.7.2025**, në orën **9:00**.
9. Fakulteti i Arkitekturës, me datë **10.7.2025**, fillon në orën **09:00**.

Grupi II:

1. Fakulteti i Filologjisë, me datë **11.7.2025**, në orën **9:00** dhe **11:00**;
2. Fakulteti i Ekonomisë, me datë **11.7.2025**, në orën **9:00**;
3. Fakulteti i Edukimit, me datë **11.7.2025**, në orën **9:00**;
4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë **11.7.2025**, fillon në orën **9:00**;

Grupi III:

1. Fakulteti i Mjekësisë, me datë **12.7.2025**, duke filluar nga ora **9:00**;

11. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të kenë me vete letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
12. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse më së largu me datë **13.7.2025** në ora **16:00**.
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet më lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të pranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare**, respektivisht më datë **14.7.2025** dhe **15.7.2025** në ora **16:00**.
3. Pas afatit të përcaktuar si në pikën e sipërshënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **16.7.2025-18.7.2025 (3 ditë pune)**.
3. Kandidatët të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë të përcaktuar si në pjesën II (Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve), paragrafët 3 dhe 4 të këtij konkursi, mirëpo për arsye se janë plotësuar të gjitha vendet e parapara në programin në të cilin kanë aplikuar, të njëjtit kanë ngelur jashtë listave të kandidatëve të pranuar, atëherë bazuar në ranglistën sipas pikëve të grumbulluara, të njëjtit mund të pranohen në programet studimore brenda njësisë akademike, në të cilat kanë mbetur vende të lira nga afati i parë i konkursit, me kusht që të kenë pasur testet e njëjta të provimit pranues.
4. Pranimi i kandidatëve si në paragrafin 3 të kësaj pike do të bëhet vetëm pas shprehjes së interesimit për pranim në programin përkatës.
5. **Në departamentet, degët, drejtimet ose programet, ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-pr.edu

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave, më së largu me datë **16.7.2025** në ora **16:00**.

VII. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UP-së (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:**
 - Fakulteti Filozofik, datë **21.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **21.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Arkitekturës, datë **22.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **22.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, datë **23.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Arteve, datë **23.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti Juridik, datë **24.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Filologjisë, datë **25.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, datë **25.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Ekonomisë, datë **28.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **29.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Mjekësisë, datë **30.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Edukimit, datë **31.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;

- Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, datë **31.7.2025**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**.

- Kandidatët të cilët nuk kanë arritur të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **3.10.2025, në orën 15:00**. Jashtë këtij afati, kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.
- Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>
 - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
 - Sipas UA (MASHTI) Nr. 09/2021, të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit kur e regjistrojnë semestrin për herë të parë.

I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **440** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studim e të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidat ë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidat ë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjiths ej
Filozofik	366	52	8	8	6	440
Departamenti i Filozofisë	41	6	1	1	1	50
Programi Filozofi	41	6	1	1	1	50
Departamenti i Punë Sociale	33	5	1	1	0	40
Programi Punë Sociale	33	5	1	1	0	40
Departamenti i Historisë	50	7	1	1	1	60
Programi Histori	50	7	1	1	1	60
Departamenti i Shkencës Politike	59	8	1	1	1	70
Programi Shkencë Politike: a) Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci b) Administrata Publike	59	8	1	1	1	70
Departamenti i Sociologjisë	59	8	1	1	1	70
Programi Sociologji	59	8	1	1	1	70
Departamenti i Psikologjisë	83	12	2	2	1	100
Programi Psikologji	83	12	2	2	1	100
Departamenti i Antropologjisë	41	6	1	1	1	50
Programi Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore	41	6	1	1	1	50

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë, nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës Sociale, nga Edukata qytetare, Psikologjia dhe Sociologjia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Historisë, nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Shkencave Politike, nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Sociologjisë, nga Sociologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Psikologjisë, nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Antropologjisë, nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **590** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studim e të rregullta	Kandidat ë nga komunitet joshumicë 12%	Kandida të nga Presheva , Bujanoci , Medvexha, 2%	Kandida të nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandida të nga Mali i Zi 1%	Gjithsëj
SHMN	487	70	12	12	9	590
Departamenti i Matematikës	138	19	3	3	2	165
Programi Matematikë	50	7	1	1	1	60
Programi Shkencë Kompjuterike	50	7	1	1	1	60
Programi Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime	38	5	1	1	0	45
Departamenti i Fizikës	65	10	2	2	1	80
Programi Fizikë	65	10	2	2	1	80
Departamenti i Kimisë	123	18	3	3	3	150
Programi Kimi	50	7	1	1	1	60
Programi Kimi Inxhinierike	50	7	1	1	1	60
Programi Kimi Ushqimore	23	4	1	1	1	30
Departamenti i Biologjisë	102	15	3	3	2	125
Programi Biologji	38	5	1	1	0	45
Programi Ekologji dhe Mbrojtje e mjedisit	41	6	1	1	1	50
Programi Biologji Molekulare	23	4	1	1	1	30
Departamenti i Gjeografisë	59	8	1	1	1	70
Programi Gjeografi	59	8	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës, nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës, nga Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Kimisë, nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë, nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë, nga Gjeografia.

Në testet e provimit pranues, të cilat kanë detyra, krahas qarkimit të përgjigjes së saktë, duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **565** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Filologjik	469	67	11	11	7	565
Programi Gjuhë Shqipe	50	7	1	1	1	60
Programi Letërsi Shqipe	50	7	1	1	1	60
Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze	101	14	2	2	1	120
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	101	14	2	2	1	120
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	41	6	1	1	1	50
Programi Gazetari	74	11	2	2	1	90
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	29	4	1	1	0	35
Programi Orientalistikë	23	4	1	1	1	30

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatës të fakultetit:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe, nga Gjuha shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Letërsisë Shqipe, nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge, nga Gjuha frënge (me shkrim);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, nga Gjuha turke (me shkrim);
- Në Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, kulturë orientale (me shkrim);

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **600** studentë të rregullt:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Juridik	498	72	12	12	6	600

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.

V. FAKULTETI I EKONOMISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1200** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
i Ekonomisë	994	144	24	24	14	1200
Programi Banka dhe financa	249	36	6	6	3	300
Programi Menaxhment	207	30	5	5	3	250
Programi Marketing	166	24	4	4	2	200
Programi Ekonomiks	124	18	3	3	2	150
Programi i Kontabilitetit	207	30	5	5	3	250
Programi Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (në Gjuhën Angleze), BSc	41	6	1	1	1	50

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.

Provimi pranues për programin Applied Economics and Management (BSc), do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë dhe Gjuhë angleze.

VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **210** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	170	26	5	5	4	210
Departamenti i Konstruksioneve	83	12	2	2	1	100
Programi Konstruktiv	83	12	2	2	1	100
Departamenti i Hidroteknikës	23	4	1	1	1	30
Programi Hidroteknikë	23	4	1	1	1	30
Departamenti i Gjeodezisë	41	6	1	1	1	50
Programi Gjeodezi	41	6	1	1	1	50
Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit	23	4	1	1	1	30
Programi Inxhinieri e Ambientit	23	4	1	1	1	30

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **510** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
FIEK	424	61	10	10	5	510
Programi Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	208	30	5	5	2	250
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	101	14	2	2	1	120
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	65	10	2	2	1	80
Programi Elektroenergjetikë	50	7	1	1	1	60

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet do të mbahet nga lënda: Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **340** studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
FIM	283	40	6	6	5	340
Programi Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale	41	6	1	1	1	50
Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme	50	7	1	1	1	60
Programi Komunikacion dhe transport	59	8	1	1	1	70
Programi Mekatronikë	74	11	2	2	1	90
Programi Dizajn Inxhinierik dhe automjete	59	8	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet mbahet nga lënda Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **462** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Mjekësisë	381	55	10	10	6	462
Programi Mjekësi e Përgjithshme	166	24	4	4	2	200
Programi Stomatologji	65	10	2	2	1	80
Programi Farmaci	41	6	1	1	1	50
Programi Infermieri	83	12	2	2	1	100
Fizioterapi dhe Rehabilitim	26	3	1	1	1	32

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

Për Programin Infermieri, kandidati duhet të ketë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë.

X. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **112** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Arteve të Bukura	97	10	1	4	0	112
<i>Departamenti i Artit Muzikor</i>	46	4	0	0	0	50
Programi Bachelor i Muzikës në Performim	46	4	0	0	0	50
Profili Solo këndim	4	0	0	0	0	4
Profili Dirigjim	1	0	0	0	0	1
Profili Piano	11	1	0	0	0	12
<i>Profili Instrumente me harqe dhe tela</i>	14	0	0	0	0	14
Moduli Violinë	6	0	0	0	0	6
Moduli Violë	2	0	0	0	0	2
Moduli Violonçelo	1	0	0	0	0	1
Moduli Kontrabas	2	0	0	0	0	2
Moduli Kitarë	3	0	0	0	0	3
<i>Profili Instrumentet frymore</i>	16	3	0	0	0	19
Moduli Flaut	5	0	0	0	0	5
Moduli Obo	1	0	0	0	0	1
Moduli Klarinetë	4	1	0	0	0	5
Moduli Trombon	2	0	0	0	0	2
Moduli Fagot	1	0	0	0	0	1
Moduli Korne	1	1	0	0	0	2
Moduli Trompete	1	1	0	0	0	2
Moduli Saksofon	1	0	0	0	0	1
Departamenti i Arteve Dramatike	51	6	1	4	0	62
Programi i Arteve Dramatike	51	6	1	4	0	62
Profili Aktrim	8	1	1	0	0	10
Profili Dramaturgji dhe Skenar filmi	6	1	0	1	0	8
Profili Regji Filmi dhe Televizioni	7	0	0	0	0	7
Profili Regji Teatri	5	1	0	0	0	6
Profili Dizajn Skene dhe Kostumografi	9	1	0	1	0	11
Profili Kamerë dhe Montazhë	8	1	0	1	0	10
Profili Produksion	8	1	0	1	0	10

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE MUZIKORE:

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në nivelin baçelor në Fakultetin e Arteve, respektivisht në profilet e Departamentit të Muzikës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

BACHELOR I MUZIKËS NË PËRFORMIM

Profili: Piano

- Provim nga lënda PIANO - (a) J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC b) 1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike (një kohë); d) 1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS;

Profili: Instrumentet me harqe dhe tela

- Provim nga instrumenti harkor përkatës - (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b) 1 Koncert (një kohë); c) 1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë cantilene;
- **Moduli: KITARË** - a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etydë nga op.6.dhe 29; c) 1 etydë për zgjedhje; d) 1 vepër ciklike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: Instrumentet frymore

- Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës- (a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1 Pjesë virtuoze;)
- Provimi nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: Solo këndim

- Provim nga lënda: SOLO KËNDIM -(a) 2 Arie (nga repertori operistik); b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: Dirigjim

- Dirigjim i një vepre për ansambël kamertal, orkestër apo për ndonjë formacion koral; (dirigjimi mund të realizohet me korepetitior ose me incizim në DVD). Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lëndët: HARMONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE DRAMATIKE:

Programi i Arteve Dramatike

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Profili: Aktrim

Pjesa e parë e programi eliminues:

- Një recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët lutën të sjellin fotografi "bust" në ditën e aplikimit.

Profili Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Profili i Regji Filmi dhe Televizioni

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash), të cilin e shfaqin para komisionit në finale.

Profili dramaturgjia dhe skenar filmi:

Zvillimi i një skene dramatike përmes dialogut, me shkrim sipas një rrethane të caktuar.

Përmbledhje (sinopsis) i një ngjarje të mundshme për një skenar filmi.

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga fusha e dramaturgjisë , kinematografisë dhe njohuri të përgjithshme.

Profili Dizajn skene dhe Kostumografi

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit të skenës dhe kostumeve duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën artevizuale@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.

Profili Produksion

Faza e parë

Kandidatët që konkurrojnë në profilin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

Faza e dytë

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, do t'i nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept- ide të një projekti teator, filmik, televiziv, apo artistik.

Faza e tretë

Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

Profili: Kamerë dhe Montazhë

Kontrolli i plotësimit të kriterëve për programin e studimit për kandidatët “Kamere dhe Montazh filmi” përbëhet nga dy pjesë:

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrohen:
 - Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.

- Një provim me shkrim - analizë (maksimum një faqe) e një filmi të shkurtër I cili prezantohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kadrimit dhe montazhit.
 - Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e Filmit, TV.
2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, Komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër, dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:
- Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, të prezantohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis në formë të shkruar jo më gjatë se një faqe.
 - Pastaj kandidati duhet ta realizojë filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet, detyra pastaj vlerësohet nga komisioni vlerësues.
 - Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlerësues, nga profili Kamerë dhe Montazh.

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, Komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në profilin Kamere dhe Montazh.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgjia, Dizajni skenë dhe Kostumografia, Produksion, Kamerë dhe Montazhë

- Georg Soddull: “Historia e filmit”
- Abaz Hoxha: “Historia e filmit shqiptar”
- Luis Herman: Skenari i filmit dhe i televizionit
- Jezhi Plazhevski: Gjuha e filmit
- Fadil Hysaj: “Teatrollogji, dramaturgjia, regji dhe aktrim”
- Aristoteli: “Poetika”
- Vlladan Shvacov: “Bazat e dramaturgjisë”
- Dr. Nebi Islami: “Historia e dramës kombëtare 1886-1996”
- Dr. Josif Papagjoni: “Komedi që vjen nga skena”
- Eskili: “Orestia”
- Sofokli: Një tragjedi
- Aristofani: Një komedi
- Shekspiri: Një tragjedi
- Molieri: Një komedi
- Dramaturgjia nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
- Dramaturgjia bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbesina etj.
- U. Gregor and E. Patalas: “History of Film”
- K. Raisz and G. Millar: “Film Editing”
- Marcel Martin: “The Language of Film”
- Jerzy Plazewski: “Jezik filma”
- Andre Bazin: “What is Cinema” (I, II, III, IV)

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **230** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Bujqësisë dhe Veterinarisë	190	28	5	5	2	230
Programi Prodhim Bimor	33	5	1	1	0	40
Programi Mjekësi Veterinare	32	5	1	1	1	40
Programi Ekonomi e Bujqësisë	33	5	1	1	0	40
Programi Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	59	8	1	1	1	70
Programi Prodhim Shtazor	33	5	1	1	0	40

PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet në lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT - PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **100** studentë të rregullt:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukimi Fizik dhe i Sportit	83	12	2	2	1	100
Programi Edukim Fizik dhe Sport	83	12	2	2	1	100
Meshkuj	50	7	1	1	1	60
Femra	33	5	1	1	0	40

Kandidatët, para se të aplikojnë, duhet të sjellin nga 2 foto dhe dëshmi për kontroll të Gjendjes Psiko-Somatike (gjendja shëndetësore, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor). Kontrolli mjekësor bëhet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, në QKUK, pranë Stadiumit "Ramiz Sadiku".

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

- Njohuritë lëvizore (motorike) sportive:
 - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë;
 - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë;
 - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh;
 - Volejbol: pasimi i topit në çifte me gishtërinj dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
- Aftësitë lëvizore (motorike):
 - Kërcimi nga vendi në gjatësi;
 - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt);
 - Përkulje mbi krah (femrat);
 - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit - meshkujt dhe femrat);
 - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor).

3. Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).
4. Not (demonstrim i një prej teknikave të notit).
5. Agjilitet (T-testi).
6. Test me shkrim (Ese e shkurtër deri në 150 fjalë).

Kriteret e poentimit janë sipas rregullores së brendshme mbi kriteret e veçanta në disiplinat përkatëse. Sportistët me rezultate të dalluara në sportet ndërkombëtare dhe ata në sportin kosovar poentohen edhe me pikë bonus, sipas kriterëve të posaçme të rregullores së brendshme. Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të kenë pajisjet sportive.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **145** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukimit	120	17	3	3	2	145
Departamenti i Edukimit Fillor	70	10	2	2	1	85
Programi Fillor	70	10	2	2	1	85
Departamenti i Edukimit në Fëmijëri të Hershme	50	7	1	1	1	60
Edukimi në fëmijëri të hershme (0-6 vjet)	50	7	1	1	1	60

PROVIMI PRANUES

- **Programi Fillor:** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;
- **Edukimi në fëmijëri të hershme (0-6 vjet):** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike.

XIV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **150** studentë të rregullt dhe atë në departamentin si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Fakulteti i Arkitekturës	124	18	3	3	2	150
Programi Arkitekturë	124	18	3	3	2	150

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimumi 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve, të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimumi 20% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

